



Legal Alert Kosovo

Minimum Wage Through 2026



Ligji i Punës i Republikës së Kosovës, përmes nenit 57, përcakton bazën ligjore për pagën minimale dhe kushtet që duhet të respektohen gjatë caktimit të saj. Sipas këtij neni, paga minimale caktohet nga Qeveria e Kosovës në fund të secilit vit kalendarik, mbi bazën e propozimit të Këshillit Ekonomiko-Social.

Gjatë propozimit dhe përcaktimit të pagës minimale, ligji kërkon që të merren parasysh, ndër të tjera, këta faktorë kryesorë:

- kostoja dhe shpenzimet e jetesës;
- përqindja e shkallës së papunësisë;
- gjendja e përgjithshme në tregun e punës; dhe
- shkalla e konkurrencës dhe produktivitetit në vend.

Paga minimale caktohet në bazë të orëve të punës dhe për një periudhë njëvjeçare.

Duke u mbështetur në këtë kornizë ligjore dhe në kompetencat e përcaktuara me Kushtetutë dhe ligj, më datë 31.10.2025, me vendimin nr. 10/273, Qeveria e Kosovës ka miratuar vendimin e ri për përcaktimin e pagës minimale.

Sipas këtij vendimi, paga minimale do të rritet në dy faza gjatë vitit 2026, si vijon:

- nga data 1 janar 2026: në nivel prej 2.50 € për një orë pune të rregullt, apo ekuivalent me 425.00 € bruto në muaj për punë me orar të plotë;
- nga data 1 korrik 2026: në nivel prej 3.00 € për një orë pune të rregullt, apo ekuivalent me 500.00 € bruto në muaj për punë me orar të plotë.

Paga minimale e re, e cila do të jetë në fuqi nga 1 janari dhe 1 korriku 2026, zëvendëson pagën minimale paraprake prej 350.00 € bruto në muaj, për punë me orar të plotë.

Zbatimi i këtij vendimi i është vënë për detyrë Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, Administratës Tatimore të Kosovës dhe Inspektoratit të Punës.

The Labour Law of the Republic of Kosovo, through Article 57, establishes the legal basis for the minimum wage and the conditions that must be followed when determining it. According to this article, the minimum wage is determined by the Government of Kosovo at the end of each calendar year, based on the proposal of the Economic-Social Council.

During the proposal and determination of the minimum wage, the law requires that, among others, the following key factors be taken into account:

- the cost of living and living expenses;
- the unemployment rate;
- the general situation in the labour market; and
- the level of competition and productivity in the country.

The minimum wage is determined based on working hours and for a one-year period.


Relying on this legal framework and on the competences, defined by the Constitution and the law, on 31.10.2025, by decision no 10/273, the Government of Kosovo approved a new decision on the determination of the minimum wage.

According to this decision, the minimum wage will be increased in two phases during 2026, as follows:

- from 1 January 2026: at the level of €2.50 per one regular working hour, or equivalent to €425.00 gross per month for full-time work;
- from 1 July 2026: at the level of €3.00 per one regular working hour, or equivalent to €500.00 gross per month for full-time work.

The new minimum wage, which will be in force from 1 January and 1 July 2026, replaces the previous minimum wage of €350.00 gross per month for full-time work.

The implementation of this decision is entrusted to the Ministry of Finance, Labour and Transfers, the Tax Administration of Kosovo and the Labour Inspectorate.

A man with a beard and glasses, wearing a light blue shirt and dark trousers, stands next to a woman with long red hair, wearing a patterned blue and white shirt and light-colored trousers. They are both looking at a tablet held by the woman. They are in a modern office hallway with large glass windows and a white ceiling with exposed pipes and lights.

Contact us

PwC Kosovo

Str. Mujo Ulqinaku, 8, Prishtina, Kosovo

Tel: +383 (0) 38 722 555

Mobile: +383 (0) 45 322 722

Email: al_pwc_kosovo@pwc.com

Web: www.pwc.com/ks